



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 288 Prot.

Tiranë, më 6.6. 2017

URDHËR

Nr. 13 Datë 6.6.2017

**Për njohjen, pranimin dhe zbatimin e KODIT EUROPIAN TË SJELLJES PËR INTEGRITET
NË KËRKIMIN SHKENCOR**

Drejtuar: Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike
Të gjithë akademikëve
Sektorit të Bibliotekës dhe të botimeve Shkencore në ASH
Sektorit të Financës

Për dijeni: Ministrisë së Arsimit e Sportit

Mbështetur ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", në Statutin dhe Rregulloren e brendshme të ASH-së, me propozim të sekretarit shkencor;

URDHËROJ:

1. Njohjen, pranimin dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të KODIT EUROPIAN TË SJELLJES PËR INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR" në veprimtarinë kërkimore shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të anëtarëve të saj, sipas tekstit bashkëmbyllur.
2. Grupi i punës për amendimin e Statutit të ASH-së, të konsiderojë shtimin tek baza ligjore e cituar në hyrje të tij edhe KODIN EUROPIAN TË SJELLJES PËR INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR.
3. Ngarkohet seksionet shkencore për zbatimin e këtij urdhëri.
4. Ngarkohet sekretarja e kryesisë, specialisti i komunikimeve shkencore dhe specialisti IT për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhëri në web-in dhe rrjetet sociale të ASH-së.
5. Ngarkohet sekretari shkencor për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhëri.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
MUZAFER KORKUTI**

